



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA
MINISTRIA E PUNËS DHE E MIRËQENIES SOCIALE
MINISTARSTVO ZA RAD I SOCIJALNE ZAŠTITE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WLFARE

Trupi Ekzekutiv i Inspektoratit të Punës/Izvršno Telo Inspektorata Rada/Exekutive Body of Labour
Inspectorate

01.Nr.06-131-2/2014

Inspektorët e Punës në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale-T E i Inspektoratit të Punës: Violetë Nishori ID 2127, Kosovare Kurdija ID 2126 dhe Ahmet Ahmeti ID 1029, të autorizuar me dispozitën e nenit 82,94 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, , nenit 1, 2 dhe 5 të Ligjit Nr.2002/9 dhe Nr.03/ L-17 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, dispozitën e nenit 13 të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, duke vendosur sipas Vendimit të TEIP si organ i shkallës së dytë Nr.106/2014 dt.08.12.2014, në procedurë të rivendosjes, më 18.12.2014 marrin këtë:

VENDIM

Kërkesa me Nr.06-131/2014 e dt.10.10.2014 e kërkuesit Arsim Halili dorëzuar në Inspektoratin e Punës lidhur me Vendimin e komisionit disiplinor të Radio Televizionit të Kosovës (RTK-së) , me seli në Prishtinë, Rr. "Xhemajl Prishtina" nr.12 është e pabazuar.

Arsyetim

Me vendimin Nr. 106/2014 dt. 08.12.2014 të TEIP- Organ i shkallës së dytë, është shfuqizuar Vendimi i Inspektorëve të Punës 01 Nr.06-131-1/2014, dt.29.10.2014, dhe lënda është kthyer në rishqyrtim, lidhur me vendosjen në bazë të kërkesës së Arsim Halili me të cilin Inspektorët e Punës kanë kërkuar nga Punëdhënësi shfuqizimin e Vendimit nr.2179/14 të dt.18.07.2014 të Komisionit Disiplinor të RTK-së , për shkak të cenimit të dispozitës së nenit 85 të Ligjit Nr.03/L212 të Punës, 14 paragrafi 14.2 dhe nenit 14 paragrafi 14.2 , 18 paragrafi 18.2 ,nenit 19 paragrafi 19.1 dhe nenit 21 të Rregullores për Përgjegjësit Materiale dhe Disiplinore të RTK-së .

Në arsyetimin e Vendimit të TEIP sugjerohet se gjatë rivendosjes Inspektorët e Punës të bëjnë administrimin e sërishëm të provave dhe në bazë të vlerësimit të tyre ti eliminojnë shkeljet esenciale, materiale dhe të nxjerrin vendim të drejtë.

Po ashtu në arsyetimin e Vendimi nr.106/2014, të TEIP theksohet se prezantimi i fakteve me ankesë dhe gadishmëria e subjektit për bashkëpunim me institucionet e Republikës së Kosovës janë rrethana të cilat duhet të shqyrtuar dhe analizuar nga inspektorët e punës sepse nga kjo shihet qartë se është një subjekt serioz , që në vazhdimësi është duke punuar për krijimin e kushteve për punonjësit me një standart në përputhje me Ligjin e Punës.

Inspektorët Punës duke i'u përmbajtur udhëzimeve të TEIP bënë administrimin e sërishëm të dokumentacionit në lëndë, dhe vërtetuan këtë gjendje faktike:

Bazuar në konstatimet e organit të shkallës së dytë rezulton se në bazë të fakteve që janë sjellë me ankesën nr.3091/14 të dt.10.11.2014 të palës në procedurë (RTK-së), kanë konstatuar se subjekti në fjalë ,ka respektuar dispoziten e nenit 85 të Ligjit Nr.03/L212 të Punës,dispozita të cilat parashohin shqiptimin e masve disiplinore ndaj punonjësve në rastë të mosrespektimit të detyrave të punës,e në këtë rast shqiptimi i mases disiplinore vërejtje me shkrim ndaj të punësuarit Arsim Halili është në harmoni me këtë dispozit ligjore si dhe ka zhvilluar procedurën disiplinore duke respektuar dispozitat ligjore të Ligjit të Punës dhe të rregulloreve të brendshme të vetë subjektit në procedurë.

Komisioni disiplinor ka konstatuar shkelje të detyrave të punës nga punonjësi Arsim Halili dhe me vendim nr. 2179/14 të dt.18.07.2014 ka shqiptuar masën disiplinore vërejtje me shkrim duke respektuar dispoziten e nenit 85 të Ligjit Nr.03/L212 të Punës dhe nga kjo rezulton se ka respektuar edhe dispoziten e nenit 14 paragrafi 14.2 ,nenit 18 paragrafi 18.2 ,nenit 19 paragrafi 19.1 dhe nenit 21 të Rregullores për Përgjegjësit Materiale dhe Disiplinore.

Gjatë marrjes së verdiktit është marr parasyshtë se provavat materiale që i janë bashkëngjitur ankesës nr.3091/14 të dt.10.11.2014 të RTK-së ,ka rezultuar se janë respektuar dispozitat e nenit 85 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës.

Në bazë të rrethanave të theksuara më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Ky Vendim është përpiluar në ekzemplarë të mjaftueshëm identik. Nga një ekzemplar i dorëzohet palëve në procedurë, ndërsa ekzemplarët tjerë mbesin në shkresat e lëndës në Inspektoratin e Punës në Prishtinë.



INSPEKTORËT E PUNËS

[Handwritten signature]

Udhëzim juridik: Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankesë në afat prej 8 ditësh, T.E. të Inspektoratit të Punës, nëpërmes Inspektoratit të Punës në Prishtinë, Rruga e "U Ç K" - Qafa L.II/2 Nr.58